Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Albina Bajrami	**02.08.2023**	**17.08.2023**	**2023/0534**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 31.07.2023, OE "Ardi SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0534, kundër njoftimit për kontratë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "Ardi SH.P.K."- Prishtinë, apo kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me material shpenzuese anti Covid per stafin e MPB-se" me nr. të prokurimit: "214-21-6523-1-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME.Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedur? t? hapur, negocuar, kufizuar, lloji i kontrat?s: pun?, furnizim, sh?rbim, vlera e parashikuar e kontrat?s: xx,xxx €.Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0534 i dt:31.07.2023.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Me datë 31.07.2023 Operatori Ekonomik "Ardi" Sh.P.K. me adresë në Rr. "Nënë Tereza" nr. 187 në Fushë Kosovë, ka parashtruar ankesën me nr. 534/2023 kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Ministria e Punëve të Brendshme për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Furnizim me material shpenzues anti Covid për stafin e MPB" me nr. të prokurimit 214-21-6523-1-2-1.

Autoriteti Kontraktues me këtë rast ka zhvilluar procedurë të hapur me llojin e kontratës për furnizim dhe me vlerë të parashikuar prej 95,000.00 €.

Bazuar në nenin 113 lidhur me nenin 114 dhe 111 të LPP, Ekspertja Shqyrtuese sipas autorizimit ka shqyrtuar pretendimet e operatorit ekonomik ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Operatori ekonomik ankues pretendon se Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenet 1, 7, 56, 59, 60, 62 dhe 72 të LPP.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë se "njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit i datës 14.07.2023 dhe vendimi për *refuzim të kërkesës për rishqyrtim i datës 25.07.2023 janë në tërësi të kundërligjshme...*".

KRITERET PËR VLERËSIM

Tenderiipërgjegjshëmmeçmiminmëtëlirë.

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

n/a

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

n/a

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

n/a

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Vendimi P.Sh. Nr. 2023/0071 i datës 25.04.2023

Vendimi P.Sh. Nr. 53/2022 i datës 12.07.2022

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

n/a

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **Ardi SH.P.K.**

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se Autoriteti Kontraktues me datë 14.07.2023 ka publikuar njoftimin mbi vendimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit me arsyetimin si në vijim:

Ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është i nevojshëm për shkak të ngjarjeve dhe/apo arsyeve objektive dhe të demonstrueshme të cilat janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe të cilat kanë qenë të paparashikueshme në kohën e inicimit të aktivitetit të Prokurimi.
Ky aktivitet i prokurimit për shkak të ankesave në OSHP, nuk ka përfunduar dhe për këtë arsye kemi kërkuar nga Njësia kërkuese e inicimit kemi marrë përgjigjeje se nuk ka nevojë për këtë furnizim dhe nuk ka mjete Buxhetore të ndara në vitin 2023 dhe vitin e ardhshëm për këtë furnizim.
Duke u mbështetur në arsyetimin nga Njësia kërkuese, bazuar edhe në Vendimin ku Qeveria e Kosovës me 24.05.2023 ka shpallur të përfunduar zyrtarisht pandeminë COVID-19, me të cilin është miratuar edhe largimi i të gjitha masave anti- COVID-19, MPB –ja ka mare vendimin për anulim të këtij aktiviteti të prokurimi.
Andaj mbi bazën e te dhënave me larte, vazhdimi i këtij aktiviteti dhe eventualisht nënshkrimi i kontratës për artikujt te cilët nuk ka nevoja AK-MPB do te shkaktonte dëmtimin e buxhetit te MPB-se dhe njëkohësisht dëmtimin e buxhetit te Republikës se Kosovës dhe rrjedhimisht është ne kundërshtim LPP.

Ekspertja shqyrtuese ka siguruar vendimin e Qeverisë së RKS të datës 24.05.2023 me nr. 05/143 të cilit i referohet Autoriteti Kontraktues (shih vendimin më poshtë):

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/143
Datë: 24.05.2023

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 89 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, në zbatim të nenit 41 të Ligjit Nr.02/L-109 për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 24 maj 2023, merr këtë:

V E N D I M
Për mbylljen e Emergjencës së Shëndetit Publik

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Shëndetësisë për mbylljen e Emergjencës së Shëndetit Publik.
2. Ministria e Shëndetësisë me Institucionet tjera përgjegjëse obligohet të vazhdoj të përcjellë situatën epidemiologjike në vend dhe të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme për menaxhimin e Pandemisë me Covid-19.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi i Qeverisë për shpalljen e Emergjencës për Shëndetin Publik me Nr.01/11 të datës 15 mars 2020.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Duke marrë parasysh situatën epidemiologjike në Kosovë dhe në zbatim të rekomandimit të Institutit kombëtar për shëndetin publik të Kosovës dhe Deklaratën e OBSh-së (05 maj 2023) për heqjen e gjendjes emergjente të shëndetit publik, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Albin KURTI
Albin Kurti
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Ekspertja shqyrtuese pas analizimit të vendimit të Qeverisë së RKS ka gjetur se ky vendim nuk ka shpallur të përfunduar zyrtarisht pandeminë Covid – 19 sikurse ka konstatuar Autoriteti Kontraktues. Qëllimi dhe fushëveprimi i këtij vendimi është për mbylljen e emergjencës së shëndetit publik dhe jo për shpalljen e përfundimit të pandemisë Covid-19. Në fakt përmes këtij vendimi detyrohen autoritetet kompetente që të vazhdojnë të përcjellin edhe më tutje situatën epidemiologjike (shih pikën nr. 2 të dispozitivit). Rrjedhimisht kjo pjesë e arsyetimit të Autoritetit Kontraktues nuk është aspak e qëndrueshme në mënyrën se si është formuluar.

Sa i përket pjesës tjetër të arsyetimit të Autoritetit Kontraktues ku thuhet se "nuk ka mjete buxhetore të ndara për vitin 2023 dhe vitin e ardhshëm për këtë furnizim", ekspertja

shqyrtuese ka gjetur se Autoriteti Kontraktues para inicimit të këtij aktiviteti të prokurimit me datë 06.09.2021 ka nxjerrë Deklaratën e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së Fondeve të vulosur dhe nënshkruar nga zyrtari kërkues, zyrtari përgjegjës i prokurimit, zyrtari kryesor administrativ dhe zyrtari kryesor financiar. Sipas këtij dokumenti Autoriteti Kontraktues ka parashikuar mjetet në vlerë 95,000.00€ për periudhën kohore 36 muaj (që nënkupton nga data 06.09.2023 deri me datën 05.09.2024).

Shih faqen e parë të deklaratës më poshtë:

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Punëve të Brendshme-Ministarstvo Unutrašnjih Poslova-Ministry of Internal Affairs

Departamenti i Prokurimit / Departman za Javnu Nabavku / Department for Procurement

Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së fondeve
Sipas Nenit 9 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Data	06.09.2021	E rezervuar për AQP Data e pranimit ___/___/_____ Identifikuesi _____
Nr. i Prokurimit:	214 21 063 1 21 214-21-6523-1-2-1	

NENI I: IDENTIFIKIMI I AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri i AK	**Ministria e Punëve të Brendshme**	Personi kontaktues e-mail	*"[shëno email-in e personit kontaktues të AK]"*
Adresa	Rr "Luan Haradinaj"- p/n ndërtesa e re e MPB-së	Kodi postar	*10 000*
Qyteti	Prishtinë	Regjioni	Prishtinë
Telefoni		Faksi	
e-mail	www.mpb-ks.org	URL:	

NENI II LËNDA E KONTRATËS

II.1.VLERËSIMI I NEVOJAVE

II.1.1 Klasifikimi (FPP)
[minimum 2 shifrat e para të FPP, cf. www.simap.eu.int]

24 01 33

II.1.2.Natyra dhe fushëveprimi:

Furnizimi me material anti Covid për stafin e MPB

II.1.3 Vlera e parashikuar 36 mujore:

95,000.00 €

Vlen të thuhet se përmes nenit 9 paragrafit 3 të LPP është përcaktuar se "*Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik ose organizatë buxhetore dhe prokurimi përkatës do të shkaktojë ngritjen e obligimeve financiare të cilat do të përmbushen nga ndarjet buxhetore që pritet të bëhen në vitet e ardhshme fiskale, ZKF do të (i) sigurojë që tabelat e bashkëngjitura Ligjit për Ndarjet Buxhetore ofrojnë bazë të arsyeshme për të pritur se në vitet a ardhshme fiskale do t'i ofrohen fonde të mjaftueshme për përmbushjen e obligimeve të tilla (ii) të përfshijë në kontratën përkatëse publike një dispozitë që qartësisht e kushtëzon zbatueshmërinë e obligimeve të parashtruara në kontratë, me legjislacionet e ardhshme të përvetësimeve, të fondeve me qëllim të përmbushjes, dhe në një shumë të mjaftueshme për përmbushjen e obligimeve të tilla*".

Tutje përmes paragrafit 5 të këtij nenit përcaktuar se "*Si dëshmi se autoriteti kontraktues është pajtuar me paragrafët 1. deri 4. të këtij neni, ZKA dhe ZKF do të përgatisin dhe nënshkruajnë një Deklaratë të Nevojave dhe Vendosshmërisë për Disponueshmërinë e Fondeve*".

Në rastin konkret nga deklarata për disponueshmërinë e fondeve e Autoritetit Kontraktues e cituar si më sipër është ndarë shuma e mjaftueshme e mjeteve buxhetore për periudhën periudhën kohore 36 muaj që nënkupton nga data 06.09.2023 deri me datën 05.09.2024. Kuptohet që sipas dispozitave të cituara më sipër Autoriteti Kontraktues është i lidhur juridikisht për të respektuar deklaratën për disponueshmërinë e fondeve që e ka nxjerrë vet me rastin e inicimit të aktivitetit të prokurimit. Prandaj arsyetimi i Autoritetit Kontraktues për anulimin e aktivitetit të prokurimit në mungesë të mjeteve buxhetore nuk është në përputhje as me LPP dhe as me vet dokumentin në fjalë. Rrjedhimisht edhe kjo pjesë e arsyetimit të Autoritetit Kontraktues nuk është aspak e qëndrueshme në mënyrën se si është formuluar.

Baza ligjore në të cilën është referuar Autoriteti Kontraktues për anulimin e aktivitetit të prokurimit është neni 62 paragrafi 1 nënparagrafi 1 ku përcaktohet se "*Autoriteti kontraktues mund të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës nëse një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit*". Termin "shkelje të ligjit" Autoriteti Kontraktues e argumenton për faktin se ky aktivitet i prokurimit është inicuar në vitin 2021 dhe nuk ka përfunduar as në vitin 2023 për shkak të kërkesave për rishqyrtim dhe vendimeve të OSHP. Ekspertja shqyrtuese vlerëson se në këtë rast Autoriteti Kontraktues ka përgjegjësinë e plotë për të zhvilluar procedurat e prokurimit të përputhje të plotë me LPP dhe legjislacionin sekondar në fuqi. Në këtë mënyrë vendimet e OSHP përmes të cilave njëri ose tjetri aktivitet mund të kthehen në rivlerësim nuk përbëjnë arsye ligjore për anulimin e aktivitetit të prokurimit. Në cilindo rast Autoriteti Kontraktues duhet të shmang shkeljen e dispozitave ligjore në fuqi në mënyrë që të shmang zgjatjet e panevojshme të aktivitetit të prokurimit. Prandaj ekspertja shqyrtuese vlerëson se edhe kjo pjesë e arsyetimit të Autoritetit Kontraktues është e paqëndrueshme. Për më tepër ekspertja shqyrtuese konsideron se në rastin konkret nuk janë përmbushur kushtet për anulimin e aktivitetit të prokurimit në kuptim të nenit 62 paragrafit 1 nënparagrafit 1 të LPP sikurse ka konstatuar Autoriteti Kontraktues.

Mbi bazën e të thënave më sipër, ekspertja shqyrtuese vlerëson se pretendimet ankimore janë të bazuara.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, ekspertja shqyrtuese i propozon panelit shqyrtues që ankesa e operatorit ekonomik ankues të miratohet si e bazuar ashtu që të anulohet njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues i datës 14.07.2023 për anulimin e aktivitetit të prokurimit ndërsa aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **Ardi SH.P.K.**

Albina Bajrami